

## **NJOFTIM**

**MBI APLIKIMIN E APLIKUESIT “AGE ERZEN” SH.P.K.  
PËR NDËRTIMIN E HEC “HEKAL”,  
ME KAPACITET PRODHUES DERI NË 2 MW,  
NË PELLGUN UJËMBLEDHËS TË LUMIT ERZEN, NË BASHKINË TIRANË,  
NË QARKUN TIRANË**

Në përputhje me Ligjin nr.43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe VKM nr. 822 datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar, Aplikuesi “AGE ERZEN” sh.p.k., ka aplikuar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për miratimin e ndërtimit të hidrocentralit “HEKAL”, me kapacitet prodhues deri në 2MW, në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, në Bashkinë Tiranë, në Qarkun Tiranë.

Aplikuesi, Shoqëria “AGE ERZEN” sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me objekt të aktivitetit: Aplikimi dhe marrja nga Qeveria Shqiptare i autorizimit për projektimin, ndërtimin dhe operimin e Hidrocentralit Erzen për prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike.

Një informacion më i detajuar lidhur me projektin mund të gjendet pranë Drejtorisë së Partneritetit Publik Privat në fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Objeksionet ose komentet lidhur me këtë aplikim mund të dërgohen në adresën e mëposhtme brenda 15 ditësh nga data e publikimit të parë.

**Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.**

**Drejtoria e Partneritetit Publik Privat në fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë**

**Rruga “Abdi Toptani”, Nr. 1,**

**Tiranë**